

RELACION

PËR

PROJEKTLIGJIN “PËR MIRATIMIN E SHITESËS SË KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, SHFRYTËZIM DHE TRANSFERIM) TË NJË PORTI TË LLOJIT MBM NË PORTO-ROMANO, DURRËS, MIRATUAR ME LIGJIN NR.104/2015, NDËRMJET MINISTRISË SË INFRASTRUKTURËS DHE ENERGJISË DHE SHOQËRISË KONCESIONARE “PORTI MBM (MULTY BUOY MOORING)”

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Ky projektligj ka si qëllim dhe objekt miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës BOT, të nënshkruar në datën 21.7.2015 dhe të miratuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin nr.104/2015, “Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”.

Shoqëria “Porti MBM” ka paraqitur kërkesë në Ministrinë e Infrastrukturës dhe Energjisë për ndryshimin e kontratës koncesionare, e cila ka si qëllim garantimin e funksionimit të linjës principale teknologjike, të paraqitur në kontratën fillestare, edhe në kushtet e paparashikuara teknike. Ndryshimet e propozuara nuk kanë si qëllim ndryshimin e kushteve të tjera thelbësore të kontratës koncesionare.

Nga ana e ministrit të Infrastrukturës dhe Energjisë u ngrit një grup pune, i cili pasi shqyrtoi kërkesën e shoqërisë koncesionare, gjeti të argumentuar kërkesën e shoqërisë, që kërkon ndryshimin e elementeve të veçanta të strukturës së objekteve të përfshira në këtë projekt, për shkak të ndryshimeve të situatës reale në terren.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Ky projektligj është në përputhje të plotë me politikat e Këshillit të Ministrave për zhvillimin e kapaciteteve depozituese portuale, rritjen e transparencës dhe të bashkëpunimit me biznesin. Ky projektligj nuk ishte i parashikuar në programin

e përgjithshëm analitik të projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave gjatë vitit 2018.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Shoqëria koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, me shkresën nr.1761 prot., datë 10.11.2017, ka paraqitur propozimin për ndryshime në kontratën e koncesionit, të miratuar me ligjin nr.104/2015.

Shkurtimisht, kërkesa e shoqërisë koncesionare bazohet në faktin që në fazën përgatitore për shtrirjen e dy tubave në det është vënë re që niveli i tabanit të detit është shumë i ndryshueshëm nga aluvjonet që vijnë nga hidrovori i Porto-Romanos, i cili derdhet në krah të tubacioneve, aluvionet që grumbullohen në anën jugore të argjinaturës së Porto-Romanos, që do të kishte distancë aksiale vetëm 50ml, si edhe nga aluvjonet që sjellin rrymat detare.

Sipas relacionit teknik të paraqitur nga shoqëria, kjo gjendje e bën linjën e tubave të paqëndrueshme dhe të rrezikuar nga dallgët e detit. Shoqëria argumenton se, e gjendur para këtij fakti, në konsultim edhe me studio prestigjioze në Evropë, të specializuara në këtë fushë, është menduar që t’i bëhet një shtesë projektit për kalimin e kësaj zone me tubacione mbi një argjinaturë artificiale.

Po ashtu, shoqëria, në relacionin teknik dhe në të gjitha komunikimet e saj, ka mbajtur qëndrimin se shtesa ka qëllim të vetëm garantimin e funksionimit të linjës principiale teknologjike, të paraqitur në kontratën fillestare, nga kushtet e paparashikuara teknike, që lidhen me marrjen e masave për mbrojtjen nga dinamika e shumëllojtë e fundit të detit në këtë zonë. Shoqëria thekson që në kërkesën e saj nuk propozohen të ndryshohen kushtet e tjera të kontratës koncesionare. Qëllimi i vetëm i këtij propozimi, sipas shoqërisë koncesionare, është fakti që të gjitha masat teknike të provuara nga ana e tyre në procesin e implementimit të projektit kanë treguar se nuk garantojnë zbatimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të linjës teknologjike.

Po ashtu, për të garantuar një qëndrueshmëri të argjinaturës dhe strukturës së tubacioneve ajrore në këtë argjinaturë, shoqëria, në bazë të studimeve, ka konkluduar se është i nevojshëm një mjet tjetër mbrojtës (dallgëthyes) me të njëjtin profil tërthor e shpatulluar në vendin më të afërt të kodrës përballë në anën jugore të linjës. Sipas mendimit edhe të projektuesit, kjo argjinaturë garanton teknikisht linjën teknologjike mbi tokë të Portit të hapur MBM.

Për sa me sipër, adresimi i kërkesës së shoqërisë koncesionare për ndryshim të kontratës koncesionare parashikohet në ligjin e posaçëm të koncesionave dhe partneritetit publik, ligji nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik

privat”, të ndryshuar. Në nenin 31, të këtij ligji, “Ndryshimi i kontratës së koncesionit/partneritetit publik privat”, parashikohet se:

“1. Kontratat e parashikuara me këtë ligj mund të ndryshohen, duke i shtuar kontratës një aneks, me kusht që kjo mundësi të parashikohet në dokumentacionin e tenderit dhe në kontratë.

2. Ndryshimet në kontratë bëhen nga autoriteti kontraktues dhe koncesionari /partneri privat.

3. Ndryshimet në kontratë mund të bëhen me iniciativën e të dyja palëve kontraktuese, veçanërisht në rastet e mëposhtme:

- a) Kur rrezikohet siguria kombëtare dhe mbrojtja e vendit, rrezikohet mjedisi, natyra dhe shëndeti i njerëzve;
- b) Kur humbet objekti i kontratës ose kur ekziston një pamundësi objektive për përdorimin e tij, në rastin e forcës madhore;
- c) Gjatë ndryshimit të kuadrit ligjor;
- ç) Në raste të tjera, që çojnë në ndryshimin e situatës reale ose ligjore për përdorimin e objektit apo ofrimin e shërbimeve ose në realizimin e kontratës.”.

Në vlerësim të kuadrit ligjor të këtij koncesioni si dhe të propozimit të bërë nga shoqëria koncesionare, u gjet e argumentuar kërkesa e shoqërisë, që kërkon ndryshimin e elementeve të veçanta të strukturës së objekteve të përfshira në këtë projekt, për shkak të ndryshimeve të situatës reale, të cilat kërkojnë ndryshime, me qëllim realizimin e këtij projekti. Në këtë mënyrë do mundësohet përdorimi i plotë i objektit të kontratës dhe ofrimi i shërbimit të dhënies me koncesion.

Grupi i punës konstaton se ndryshimet e propozuara nuk ndryshojnë kushtet thelbësore të kësaj kontrate, që janë të përcaktuara në dispozitat e kontratës koncesionare dhe që kanë shërbyer si bazë për garën koncesionare dhe për përzgjedhjen e koncesionarit fitues. Ndryshimi i propozuar nuk ndikon në pranimin e ngarkim-shkarkimit të mjeteve lundruese që transportojnë hidrokarbure të madhësive mbi 20 000 tonë dhe as nivelin e zhytjes së anijeve që transportojnë hidrokarbure me zhytje mbi 8 metra.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Ndryshimet e propozuara, në tërësi, janë në përputhje të plotë me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për koncesionet.

Në bazë të shkronjës “ç”, të pikës 2, të nenit 31, të ligjit nr.125/2013, “Për koncesionet dhe partneritetin publik/privat” parashikohet mundësia e ndryshimit

të kontratave koncesionare me marrëveshje ndërmjet palëve në rast se ato përballen me raste që çojnë në ndryshimin e situatës reale për përdorimin e objektit ose në realizimin e kontratës.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Ky projektvendim nuk ka për qëllim përafrimin e legjislacionit me *Acquis Communautaire*.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj konsiston në miratimin e shtesës së kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, shfrytëzim dhe transferim) të një porti të llojit MBM në Porto-Romano, Durrës, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe shoqërisë koncesionare “Porti MBM (*Multy Buoy Mooring*)”, miratuar me ligjin r.104/2015.

Shtesa e kontratës është e përbërë nga pjesa përshkruese dhe përmban, gjithsej, 5 nene, e shoqëruar me anekse.

Neni 1, i marrëveshjes, bën reflektimin e ndryshimeve të nevojshme në vlerën e investimit, pas miratimit të ndryshimeve në projekt.

Neni 2 bën ndryshimin e aneksit 1 me aneksin 1/1. Në këtë aneks përfshihen ndryshimet e nevojshme në skemën e projektit të koncesionit.

Neni 3 bën reflektimin e detajimit të tabelës së investimit të përfshirë në aneksin 3 të kontratës fillestare.

Në nenin 4 parashikohet që koncesionari dhe shoqëria koncesionare, gjatë ndërtimit dhe operimit të koncesionit, do të zbatojnë legjislacionin në fuqi për peshkimin dhe atë mjedisor si dhe çdo detyrim e angazhim tjetër, të marrë përsipër në kontratën koncesionare.

Në nenin 5 janë dispozitat që lidhen me numrin e kopjeve të kontratës së nënshkruar dhe hyrjen në fuqi të saj.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E PROJEKTAKTIT

Për zbatimin e projektligjit ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, së bashku me institucionet e saj të varësisë.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji është hartuar nga strukturat përgjegjëse të Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Zbatimi i projektligjit nuk shoqërohet me shpenzime financiare shtesë për buxhetin e shtetit.

KËSHILLI I MINISTRAVE